



INTERNATIONAL
UNIVERSITY OF STRUGA

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR NË STRUGË

KONKURS

**Për regjistrimin e studentëve në programet studimore të ciklit të parë dhe
dytë të studimeve në Universitetin Ndërkombëtar në Strugë në vitin akademik
2025/2026**

STRUGË

MARS, 2025

Në bazë të nenit 103 dhe 149 të ligjit për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare nr.82/18) dhe nenit 142 nga Statuti i Universitetit Ndërkombëtar – Strugë, në mbledhjen e mbajtur më 03.03.2025, Rektorati i Universitetit Ndërkombëtar - Strugë solli vendim për publikimin e konkursit për regjistrimin e studentëve nga cikli i parë dhe dytë i studimeve. Në bazë të Ligjit për Arsim të Lartë, Statutit të Universitetit dhe në përputhje me vendimin nga mbledhja e Rektoratit të Universitetit për përcaktimin e numrit të studentëve në regjistrimin e vitit të I-re në studime deridiplomike në vitin **2025/2026** propozohet numri i mëposhtëm i studentëve:

**I. CIKLI I PARË I STUDIMEVE AKADEMIKE-STUDIME TREVJEÇARE (180-EKTS)
NIVELI VI-B**

1. Numri i studentëve për vitin akademik 2025/2026

Studime të rregullta për Diplomë Maqedonase	Gjuha e studimeve				Vendi i studimeve	Çmimi për studime për semestër	Studime të rregullta për diplomë të dyfishtë (Diplomë Amerikane)
	SHQ	MAQ	ANG				
FAKULTETIT I SHKENCAVE JURIDIKE							
Studime të Jurisprudencës	260				SU; GV	500-2400 euro	15
Kriminalistikë dhe Detektiv	200				SU; GV	500-2400 euro	
TOTALI	460						
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE							
Ekonomi dhe biznes	280				SU; GV	500-2400 euro	15
Financa dhe Marketing	120				SU; GV	500-2400 euro	
TOTALI	400						
FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE							
Diplomaci dhe marrëdhënie ndërkombëtare	160				SU; GV	500-2400 euro	15
TOTALI	160						
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT							
Shkenca Kompjuterike	160				SU; GV	500-2400 euro	15
TOTALI	160						

II.CIKLI I PARË I STUDIMEVE AKADEMIKE - STUDIME KATËRVJEÇARE (240 EKTS)

NIVELI VI- A

2. Numri i studentëve për vitin akademik 2025/2026

Studime të rregullta për Diplomë Maqedonase	Gjuha e studimeve				Vendi i studimeve	Çmimi për studime për semestër	Studime të rregullta për diplomë të dyfishtë (Diplomë Amerikane)
	SHQ	MAQ	ANG				
FAKULTETIT I SHKENCAVE JURIDIKE							
Kriminalistikë dhe Detektiv	160				SU; GV	500-2400 euro	15
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE							
Ekonomi dhe biznes	160				SU; GV	500-2400 euro	15

*Në përputhje me nenin 144 alineja 7 nga Ligjit për arsim të lartë (Gaz.zyrtare e RMV-së nr.82/18), mësimdhënja e së paku 2 programeve studimore në ciklin e parë të studimeve akademike dhe studimeve të specializuara në mënyrë të obliguar jepet mësimi dhe provimet në gjuhën angleze. Sipas kësaj, tek programet studimore për Financa dhe Marketing të Fakultetit të shkencave ekonomike dhe Shkenca Kompjuterike në Fakultetin e Teknologjisë Informative, nga 20 student do të mund të ndjekin dhe bëjnë provime në gjuhën angleze.

I. Kushte dhe kritere për regjistrim

Universiteti përcakton kriteret mbi bazën e të cilave kryhet përzgjedhja e kandidatëve për regjistrim në studime. Në ciklin e parë të studimeve akademike mund të regjistrohet personi që ka kaluar maturën shtetërore ose maturën ndërkombëtare ose ka përfunduar arsimin e mesëm katërvjeçar sipas rregulloreve që kanë qenë të vlefshme para futjes së maturës shtetërore.

Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm para vitit akademik 2007/2008 dhe nuk kanë dhënë provimin e maturës shtetërore, si dhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm në vitin akademik 2019/2020 dhe nuk kanë dhënë provimin e maturës shtetërore për shkak të pandemisë COVID. kanë të drejtë të regjistrohen.

Në studimet universitare kanë të drejtë të regjistrohen kandidatët me arsim të mesëm katërvjeçar ose të barazvlefshëm, si dhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë R.Maqedonia e Veriut.

Studentët e huaj regjistrohen në institucionet private të arsimit të lartë me të njëjtat kushte si qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe paguajnë shkollimin në shumën e përcaktuar nga universiteti.

Kandidatët regjistrohen si studentë me kohë të plotë ose të pjesshme me financim studimi.

Në njësitë e Universitetit, mund të regjistrohen si **studentë me korrespondencë** kandidatët që plotësojnë kushtet për regjistrim dhe janë në marrëdhënie pune, si dhe kandidatët që për arsye të justifikuar nuk mund të regjistrohen si studentë të rregullt.

Arsyet e justifikuar sipas paragrafit të mëparshëm përfshijnë:

- Persona me aftësi të kufizuara që nuk janë në gjendje të ndjekin mësim të rregullt
- Sëmundje e rëndë afatgjatë
- Prindër të fëmijëve derisa vazhdon periudha e pushimit për lindje
- Nënata me fëmijë deri në moshën gjashtë vjeçare

II. Njohja e gjuhëve

Kandidatët të cilët do testohen për njohuritë e tyre për shkallën e njohjes së gjuhës angleze. Ky testim nuk ka karakter eliminator, por është i nevojshëm për përcaktimin e shkallës së njohjes së gjuhës angleze.

III. Afate për aplikim

REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE - 2025/26 -	AFATI I PARË PËR REGJISTRIM	AFATI I DYTË PËR REGJISTRIM
	Paraqitja e kandidatëve	18.08.2025 - 29.08.2025
Regjistrimi i kandidatëve	08.09.2025 и 09.09.2025	30.09.2025

IV. Dokumentet për aplikim dhe regjistrim

Gjatë aplikimit për regjistrim në fakultete kandidatët për studime deridiplomike i dorëzojnë dokumentet që vijojnë:

1. Fletëparaqitje për regjistrim
2. Dëftesat origjinale nga të gjitha klasët (Ose kopje të noterizuara)
3. Dëftesat për arsim të mesëm të kryer (ose kopje të noterizuara)
4. Vërtetim për shtetësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut (vërtetim ose vendim)
5. Dy fotografi (madhësia për pasaportë)
6. *për studentët që vijnë nga jashtë R.së Maqedonisë Veriut, kopje të pasaportës
7. **për studentët me korrespondencë** - kopje e Formularit M1 dhe M2 të vërtetuar nga notari ose dëshmi mjekësore për arsyet (e lëshuar nga një institucion shëndetësor përkatës), dëshmi që është prind i një fëmije për të cilin ende vazhdon e drejta e pushimit për lindje, ose dëshmi që është nënë e një fëmije deri në moshën gjashtë vjeçare.

V.FINANSIMI I STUDIMEVE

Shuma për një vit studimor për studentët e studimeve deridiplomike dhe të magistraturës kushton prej 500 - 2400 euro.

*Studentët të cilët regjistrohen në përputhje me këtë konkurs, në mënyrë automatike i pranojnë të gjitha kushtet financiare të parapara në këtë konkurs.

VI.Studimet e ciklit të parë të studimeve janë në kohëzgjatje prej 3 deri më 4 vite, respektivisht 6 deri më 8 semestra.

Në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës në vitin akademik 2025/26 mund të kryhet transfer dhe regjistrim i studentëve në të gjithë fakultetet:

- FAKULTET I SHKENCAVE JURIDIKE, në drejtimet:
 - Studime të Jurisprudencës - 80 student
 - Kriminalistikë dhe Detektivë - 80 student
- FAKULTETI SHKENCAVE EKONOMIKE, në drejtimet:
 - Ekonomi dhe Biznes - 80 Student
 - Marketing dhe Menaxhment Financiar - 80 Student
- FAKULTETIT I SHKENCAVE POLITIKE, në drejtimet:
 - Diplomaci dhe Marrdhënie Ndërkombëtare - 40 Student
- FAKULTETI PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE, në drejtimet:
 - Shkenca kompjuterike - 40 Student
 - Biznes Informatikë - 40 Student

1. Kushtet për transfer të studentëve të UNS

A. Transfer i brendshëm – Studentë me status student i UNS:

1. Për transfer të brendshëm të njërive ekzistuese akademike të UNS, kanë të drejtë të gjithë studentët të cilët kanë status student i UNS.

B. Transfer i jashtëm – për kandidatët të cilët nuk janë student të UNS:

1. Transfer nga institucione të tjera të arsimit të lartë në R. Maqedonisë së Veriut dhe jashtë, në njërin nga njësitë ekzistuese akademike të UNS, kanë të drejtë të gjithë studentët të cilët kanë regjistruar (së paku një vit akademik) ose janë diplomuar në Universitetin nga i cili vijnë.
2. Studenti mund të kryejë transfer në njërin nga fakultetet ose qendrat ekzistuese, në programin e njëjtë ose të ngjajshëm ose drejtim me fakultetet dhe programet studimore të UNS.
3. Studentët të cilët do të regjistrohen me transfer duhet të sjellin dëshmi për provime të dhëna nga institucioni i mëparshëm i arsimit të lartë.

2. Në UNS mund të regjistrohen edhe kandidatët të cilët kanë kryer Shkollë të lartë ose ngjajshëm.

1. Transferi i tyre kryhet në bazë të ekuivalencës ose ngjajshmërisë të provimeve të dhëna dhe programeve studentore nga arsimimi paraprak.

Kandidatët të cilët do të kryejnë transfer në UNS, regjistrohen si studentë me status për të studjuar me vetëfinansim.

3. Afatet për aplikim për transfer dhe regjistrim të studentëve janë këto që vijojnë:

REALIZIMI I KONKURISIT PËR TRANSFER TË STUDENTËVE - 2025/26 . -	AFATI I PARË REGJISTRIMIT		AFATI I DYTË I REGJISTRIMIT		AFATI I TRETË I REGJISTRIMIT	
Paraqitja e kandidatëve	02.06. – 27.06.2025		18.08 – 29.08.2025		12.01 – 30.01.2026	
Regjistrim i kandidatëve	04.07.2025		05.09.2025		05.02.2026	

4. Dokumentacioni i nevojshëm për Aplikim dhe Regjistrim:

- Fletë aplikim (e cila mund të merret nga departamenti i Çështjeve Studentore të UNS ose nga web faqja zyrtare e UNS www.iust.edu.mk)
- Çertifikatë notash ose Indeks nga Universiteti Amë;
- CV (biografi e shkurtër) në formë eseji;
- Dëftesa origjinale dhe diploma (ose kopje të noterizuara në Notar) për arsim të kryer
- Çertifikatë e lindjes dhe Nënshetësi
- Dy fotografi (4x5)

Në ciklin e dytë të studimeve në vitin akademik 2025/26 studentët mund të regjistrohen në këto programe studimore:

1.CIKLI I DYTË I STUDIMEVE AKADEMIKE- STUDIME DYVJEÇARE(120 EKTS)- NIVELI VII A

Në vitin e katërt të studimeve të specijalizuara në vitin akademik 2025/26 mund të regjistrohen studentë në këto fakultete dhe drejtime:

- FAKULTET I SHKENCAVE JURIDIKE, në drejtimet:
 - Studime të Jurisprudencës - 180 student
 - Kriministikë dhe Detektivë - 180 student

- FAKULTETI SHKENCAVE EKONOMIKE, në drejtimet:
 - Ekonomi dhe Biznes - 160 Student
 - Financa dhe Marketing - 120 Student

- FAKULTETIT I SHKENCAVE POLITIKE, në drejtimet:
 - Diplomaci dhe Marrdhënje Ndërkombëtare - 160 Student

- FAKULTETI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE në drejtimin:
 - Biznis Informatikë - 160 Student

Studimet e specijalizuara zgjasin dy vite studimore (katër semestra). Pas përfundimit të provimeve studentët fitojnë titullin nga fusha konkrete e studimeve.

Në studimet e specijalizuara mund të regjistrohet personi i cili ka kryer programin studimor nga cikli i parë (studime deridiplomike) me 180 EKTS kredi. Në studime të specijalizuara mund të regjistrohet dhe personi i cili ka përfunduar arsim të lart nga cikli i parë i studimeve, me 180 EKTS kredite, jashtë R.së Maqedonisë së Veriut. Shtetasit e huaj mund të regjistrohen në të njëjtat kushte si edhe shtetasit e R.së Maqedonisë së Veriut.

2.CIKLI I DYTË I STUDIMEVE AKADEMIKE - STUDIME NJË-VJEÇARE (60 EKTS) - NIVELI VII A

Në ciklin e dytë të studimeve akademike – studime pasuniversitare në vitin akademik 2024/2025, studentët mund të regjistrohen në këto fakultete dhe programe studimore:

- FAKULTETI I SHKENCAVE JURIDIKE, në programin e studimit:
 - Kriministikë dhe detektivë - 80 studentë

- FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE të programit të studimit:
 - Ekonomi dhe Biznes - 80 studentë

Studimet pasuniversitare zgjasin një vit akademik (dy semestra). Në një program studimi pasuniversitar që zgjat një vit dhe me të cilin fitohen 60 kredite ECTS, mund të regjistrohet vetëm personi i cili ka përfunduar studimet univerzitare që zgjasin së paku 4 vjet dhe ka fituar së paku 240 kredite ECTS.

1. Afatet e rregjistrimit

Realizimi i Konkursit për rregjistrimin e studentëve 2025-2026	I AFATI I	II AFATI I
	Paraqitja e kandidatëve	22.09.2025 - 30.09.2025
Rregjistrimi i kandidatëve	06.10.2025 n 07.10.2025	06.11.2025 n 07.11.2025

Pas paraqitjes për regjistrim në fakultet, kandidatët për studime postdiplomike i sjellin këto dokumentacione:

1. Paraqitje për regjistrim
2. Certificate origjinale për studimet e kryera deridiplomik
3. CV dhe vërtetim për mësim praktik
4. Vërtetim shtetësie të R.së Maqedonisë së Veriut (certificate ose vendim)
5. Dy fotografi

Kandidatët që konkurrojnë për regjistrim, dokumentet e nevojshme duhet t'i dorëzojnë në adresën e mëposhtme:

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë
Lagjja Ezerski Lozja nr. 1
6330 Strugë, RMV

**Në përputhje me nenin 144 alineja 7 nga Ligji për arsim të lartë (Gaz.zyrtare e RM-së nr.82/18), mësimdhënja e së paku 2 programeve studimore në ciklin e parë të studimeve akademike dhe studimeve të specializuara në mënyrë të obliguar jepet mësimi dhe provimet në gjuhën angleze. Sipas kësaj, tek programet studimore për Financë dhe Marketing të Fakultetit të shkencave ekonomike dhe Shkencave Kompjuterike në Fakultetin e Teknologjisë Informative, nga 10 student do të mund të ndjekin dhe bëjnë provime në gjuhën angleze*

* * *

Konkursi do të jetë i publikuar në faqen e Internetit:
<http://www.iust.edu.mk>